

## **Performanca dhe impakti i veprimtarisë audituese të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit për vitin 2016**

Në datë 24 Janar 2017, Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit zhvilloi në sallën e konferencave të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, në Durrës, Analizën Vjetore të punës së Departamentit për vitin 2016.

Fjalën e hapjes e mbajti Sekretari i Përgjithshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit, zj. Luljeta Nano, e cila bëri një pasqyrë të shkurtër të punës së institucionit për vitin 2016, ku theksoi se KLSH si institucion suprem i auditimit publik ka detyrimin ndaj qytetarit dhe Kuvendit që me misionin, forcën dhe moralin që i ka dhënë Kushtetuta, të kthejë besimin publik ndaj qeverisjes.



Analizën e nderuan me pjesëmarrjen e tyre, Rektori i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, znj. Kseanela Sotirofski, Dekani i Fakultetit të Biznesit, znj. Azeta Tartaraj, Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, znj. Valbona Sako, Kryetar i Degës së Doganës Durrës, z. Artan Sulejmani, pedagogë dhe studentë të fakultetit. Një fjalë përshëndetëse u mbajt nga znj. Azeta Tartaraj dhe znj. Valbona Sako.

Analiza vjetore e punës së departamentit vijoi me Raportin e Performancës së veprimtarisë së Departamentit për vitin 2016, e cila është ndërtuar në bazë të strukturës së standardizuar të Kornizës së Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit të miratuar në Kongresin e XXII të INTOSAI-it, Abu Dhabi”, mbajtur nga Kryeaudituesi i Departamentit z. Vullnet Karafilaj.

Nga analiza e gjetjeve për 14 auditimet e evaduara, janë evidentuar mospërputhje të veprimtarisë me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator të shoqëruara me **të ardhura të**

**munguara në vlerën 4,400,321 mijë lekë** rekomanduar 100% për zhdëmtim, nga të cilat **2,935,679 mijë lekë në të ardhurat në sistemin doganor** dhe **1,464,642 mijë lekë në të ardhurat në sistemin tatimor**. Gjithashtu janë rekomanduar gjithsej 414 masa nga të cilat, 141 masa organizative, 84 masa shpërblim dëmi, 26 masa administrative dhe 163 masa disiplinore.

Mbi auditimet me gjetjet dhe impaktet më të rëndësishme diskutuan z. Agron Opari “Auditimi në Degën e Doganës Fier”, z. Artan Mirashi “Auditim Performance mbi vlerësimin doganor” dhe Znj. Elida Koçani “Auditimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër (pilot)”.

Në vijim të punimeve të analizës, audituesit referuan lidhur me botimet e kolanës së KLSH-së, “4 vjet Auditim Publik 2012-2015”, nga z. Albert Thoma dhe “Botimi i ISSAI-ve I-400”, nga z. Vladimir Rizvani.

Më pas u vijua me prezantimin e rezultateve të Kontrollit të Cilësisë për auditimet e ushtruara gjatë vitit 2016, nga Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, prezantim i cili u krye nga z. Pullumb Beqiraj, anëtar i grupit të Kontrollit të Cilësisë.

Në përfundim, kryeaudituesi i departamentit z. Vullnet Karafilaj, prezantoi objektivat dhe sfidat e departamentit për vitin 2017, ku u theksua se, për të realizuar misionin tonë, duhet të udhëhiqemi në punën tonë audituese mbi vlerat dhe parimet e mëposhtme: Pavarësia, Objektiviteti, Integriteti, Përgjegjshmëria, Profesionalizmi, Bashkëpunimi, Interesi publik dhe Transparenca.